



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opstina Kaçanik
Municipality of Kaçanik

ZYRA E KRYETARIT

01-Nr. 126/07-8253 22
Data: 18.03.2022

Në mbështetje të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6, pika b dhe h, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut,

Propozon

Në mbështetje të nenit 12. të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 17 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e datës _____ të merr këtë:

VENDIM

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTEZIM
TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej 5 anëtarëve; prej tyre tre (2) anëtar propozohen nga Kryetari i Komunës nga radhët e ekzekutivit të Komunës, tre (2) anëtar propozohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi, ka këtë përbërje:
 1. _____; anëtar (ekzekutivi)
 2. _____; anëtar (ekzekutivi)
 3. _____; anëtar (PDK)
 4. _____; anëtar (LVV)
 5. _____; anëtar (Shoqëria Civile)
3. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës është përgjegjës: Të sigurojë që konkursi i hapur të mbahet në përputhje me procedurat e Ligjit dhe Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të sigurojë që dokumentet të janë në dispozicion për pjesëmarrësit në konkurrim, të sigurojë që konkursi është shpallur në web-faqen

e komunës dhe tabelën e komunës për shpallje publike, të sigurojë konfidencialitet për personat ose subjektet që marrin pjesë në konkurrim.

4. Organet relevante të administratës dhe njësitë tjera të organeve të saja, do t'i ofrojnë përkrahje Komisionit Vlerësues.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim:

Formimi i Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut ka rëndësi shumë të madhe për zhvillimin ekonomik lokal si dhe në rritjen e të hyrave vetanake të Komunës. Andaj, rekomandohet të zbatohen të gjitha procedurat dhe të formohet komisioni konform dispozitave të këtij propozim vendimi.



Kryetari i Komunës


z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01-60/01-7922/22

Kaçanik, 21.03.2022

DRAFT PLANI VJETOR I PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL TË SIGURISË NË BASHKËSI, PËR VITIN 2022

HYRJE

Plani Vjetor i Punës i KKSBS-së përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSBS-së, në përmbushje të qëllimit të funksionimit të KKSBS-së. Plani efektiv i punës ka për bazë strategjinë komunale për përafrimin e objektivave dhe burimeve.

Ky plan i punës synon të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ të KKSBS-së.

KKSBS nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e caktuara në PVP-së, por do të jetë aktive dhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme si dhe përçimin e kërkesave të kësaj natyre.

Po ashtu, KKSBS do të krijojë raporte të rregullta me Kuvendin e Komunës dhe të kërkojë nga legjislativi lokal mbështetjen e funksionimit të KKSBS-së, sikundër edhe përkrahjen e iniciativave dhe projekteve konkrete në të mirë të sigurisë së qytetarëve.

KKSBS do të monitorojë trajtimin nga Komuna të rekomandimeve që dalin nga ky këshill.

Plani Vjetor i Punës së KKSBS-së është orientues dhe jo domosdoshmërisht do të kufizohet vetëm në pikat e sipërpërmendura. Ky këshill do të trajtojë edhe tema të tjera, varësisht nga kërkesat dhe zhvillimet gjatë këtij viti.

Në përputhje me nenin 11, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ të KKSBS, kjo e fundit mund të mbajë edhe takime të tjera, varësisht nga nevojat e paraqitura në ndërkohë.

PËRBËRJA E KKSBB-së

	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Nr. i tel.	Email adresa
1	Besim Ilazi-Kryesues i KKSBB	Kryetar i Komunës	0290 380005 044 116 133	Besim.q.ilazi @ks-gov.net
2	Sabedin Vishi	Nënkryetar i Komunës	044 814 756	Sabedin.vishi@rks-gov.net
3	Zahir Doda	Drejtör i Arsimit	044 225 351	zahir.doda@rks-gov.net
4	Halim Shehu	Komandant i Stacionit të Policisë në Kaçanik	0290 380 834 044 219 530	halim.shehu @kosovopolice.com
5	Fidaim Fazliu	Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik	0290 380 076 044 887 455	fidaim.fazliu.1@gmail.com
6	Fadil Guri	Zyra për Kthim dhe komunitete	044 228 115	fadil.guri@rks-gov.net
7	Vedat Dema	Zyra për Barazi Gjimore	044 279 386	vedat.dema@rks-gov.net
8	Jashar Selimi	Këshilli i Prindërve	046 164 799	jasha888@hotmail.com
9	Përfaqësuesi i FSK			KOC@fsk-rks.org
10	Ekrem Livoreka	Komiteti për Komunitete	044 679 889	ekrem.livoreka@gmail.com
11	Bujar Bajra	Spektori i Emergjencave Civile dhe Komunale	044 183 217	bujar.bajra@rks-gov.net
12	Ylber Tusha	Përfaqësuesi i Bizneseve	044 227 825	ylber.rrapi@gmail.com
13	Elmihane Malsiu	HANDIKOS	044 235 717	handikoskaqanik@hotmail.com
14	Naim Hysa	Kryqi i Kuq	044 224 881	kacanik@redcross-ks.org
15	Shemsedin Abazi	KLSP	044 224 685	shabazi@hotmail.com
16	Fatmir Qaka	EVSB	044 346 157	fatmirqaka@hotmail.com

OBJEKTIVAT E KKSBB-së NË PVP 2022

KKSBB do të interesohet edhe në kërkimin e donatorëve të brendshëm e të jashtëm për zbatimin e projekteve konkrete në lëmin e sigurisë, fushata vetëdijësuese, etj.

KKSB do të shqyrtojë edhe çështje të tjera të cilat ndërlidhen me objektivat, detyrat dhe kompetencat e këtij organi konsultues:

- Trajtimi i temave të ekstremizmit
- Iniciativat e përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë
- Përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të gjithë qytetarëve, për çështjet që lidhen me sigurinë e jetës së tyre
- Zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi
- Identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike
- Rekomandimin e planeve të veprimit
- Bashkëpunimin me strukturat e sigurisë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi
- Informimin e Kuvendit Komunal dy here brenda vitit për aktivitetet e KKS-së

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi në komunën e Kaçanikut, edhe gjatë vitit 2022 do të jetë në funksion të realizimit të objektivave, komforit dhe kompetencave që ka. Ndër objektivat e KKS-së, më me përkushtim do të trajtohen:

- Identifikimi i problemeve që cenojnë sigurinë e qytetarëve
- Inicimin e zgjidhjeve të problemeve që kërcënojnë sigurinë publike dhe jo vetëm
- Thirrje për vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve
- Parandalimi i veprimeve të dhunshme
- Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimi i shqetësimeve të qytetarëve te institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive të komunës së Kaçanikut

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi po ashtu, do të ofrojë mundësinë për adresimin e gjerë të problemeve me të cilat mund të përballen qytetarët, siç janë: siguria në shkollë, e cila mund të trajtohet në nivelin lokal përmes koordinimit të organeve të shkollës, prindërve, mësimdhënësve, Drejtorisë së Arsimit, drejtorive komunale përkatëse, policisë dhe akterëve të tjerë.

KKSB-së do të trajtojë ide, plane, propozime, sugjerime dhe projekte konkrete për fushën e sigurisë publike dhe jo vetëm.

Ky organ konsultues komunal, do të diskutojë edhe tema të tjera që ndërlidhen me veprat penale e kundërvajtëse, me theks të veçantë: përdorimin e armëve nëpër ahengje familjare dhe organizime të ndryshme, sigurinë në komunikacion, përhapjen e zjarreve, prezencën e qenëve endacakë dhe rrezikun e shumëfishtë nga kjo kafshë pa pronar, përdorimin e substancave narkotike nga të rinjtë, sigurinë në shkollë, mbeturinat në rrugë e në hapësira publike, vjedhjet individuale dhe të organizuara, prishjen e qetësisë publike, lirimimin e hapësirave publike për sigurinë e lëvizjes së qytetarëve, sigurinë e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e ambientit, sigurinë higjienike e sanitare të hapësirave të cilat frekuentohen dhe shfrytëzohen nga qytetarët, sigurinë e konsumatorëve nga produktet ushqimore etj. Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi, siç është përmendur edhe më lart, do të insistojë në kërkesat e donatorëve dhe institucioneve lokale, për financimin e projekteve konkrete të cilat do të implementohen nga qeveria komunale.

Projektet më me prioritet, disa prej të cilave vazhdojnë qe disa vite t'i prijnë listës, janë:

- Trajtimi i dukurisë së vjedhjeve dhe dukurive të tjera të cilat e dëmtojnë qytetarin e komunës së Kaçanikut
- Rregullimi i infrastrukturës fizike (pjerrinave, ashensorëve, shkallëve emergjente) nëpër institucione
- Ndërtimi i trotuareve për sigurinë e qytetarëve në lokalitetet në të cilat mungojnë ato
- Vendosja e kamerave të sigurisë në institucione dhe në hapësira publike
- Vendosja e pengesave (policëve të shtrirë) nëpër lokacione urbane e jo urbane, sidomos afër shkollave
- Vendosja e hidrantëve publik nëpër rrugët kryesore të qytetit, për përgjigje të shpejtë dhe efikase ndaj përhapjeve eventuale të zjarreve
- Largimi i deponive të egra
- Parandalimi huliganizmit nëpër shkollat e komunës
- Luftimin e narkomanisë dhe dukurive tjera negative
- Adresimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve

Plani i punës i KKSB-së do të zbatohet në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe 03/2012 të MAPL-së dhe si i tillë, nga anëtarët e KKSB-së i përcillet për miratim KK të Kaçanikut.

Nr. Re.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përshkrimi i shkurtër i iniciativës/ projektit	Përgatit	Shqyrton
1.	SHKURT	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut, - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut për vitin paraprak, - Siguria në Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Kaçanikut 2. Të ndryshme	Kryetari i komunës Drejtori i DAK dhe Komandanti i policisë raporton para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari, policia dhe Koordinatori	Anëtarët e KKSB-së
2.	PRILL	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut - Trotualet, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese. - Qentë endacak. 2. Organizimi i Takimit Publik me	-Kryetari i komunës dhe Komandanti i policisë raporton para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së	Shqyrtimi i problemeve të sigurisë të cilat i preokupojnë banorët	Anëtarët e KKSB-së

		qytetarët kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane rreth sigurisë publike, 3.Të ndryshme	sigurisë për muajt raportues. - Shqyrtimi i problemeve të sigurisë të cilat i preokupojnë banorët		
3.	QERSHOR	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut, - Shqyrtimi i dukurive negative - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla. - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror, 2.Të ndryshme	Kryetari i komunës, Komandanti i policisë, së dhe drejtori i emergjencave raportojnë para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues	Kryetari i Komunës, policia dhe koordinatori i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së
4.	KORRIK	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut, - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm, - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve, -Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, - Siguria ne Trafik, - Gjendja e sigurisë në shkolla, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla. - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Kaçanikut, 2. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit , multi-kulturorë dhe ndër – fetar. 3.Të ndryshme	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia dhe DAK-ja, raportojnë para anëtarëve të KKSB-së	Kryetari i Komunës Policia. Koordinatori KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së
5.	SHTATOR	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut, - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë, - Gjendja e sigurisë në shkolla - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, - Siguria në trafik	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë Drejtoria e Bujqësisë dhe DAK-ja, raportojnë para anëtarëve të KKSB-së	Kryetari i Komunës, policia	Anëtarët e KKSB-së

		- Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje -Përgatitjet për sezonin dimërorë 2.Formimi i grupit për përpilimin e Planit të punës së KKSBS për vitin 2022 3.Të ndryshme			
6.	DHJETOR	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut. -Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike. - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBS për vitin 2022. 3.Të ndryshme	-Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSBS-së Policia e Kosovës DSHP -Bëhet përgatitja e Planit të Punës së KKSBS-së nga Kryetari i Komunës Koordinatori KKSBS-së dhe grupi për hartimin e planit dhe përcillet në Kuvend Komunal për miratim	Kryetari i Komunës, Policia anëtarët e KKSBS-së, koordinatori	KKSBS



Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi

[Handwritten signature]



18.03.2022
06-941/01-4538/2022

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092, për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme dhe nenit 6 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit bënë këtë:

PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2022, të merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK, PËR KËMBIMIN E PRONËS KOMUNALE ME ATË PRIVATE

I. VËRTETOHET se parcela me nr: 00585-2- në zonën kadastrale Ivajë, me sipërfaqe të përgjithshme 122 m², është me interes të përgjithshëm publik dhe mund të fillojnë me procedurat e këmbimit të pronës komunale me pronën e paluajtshme private.

II. Sipas këtij propozimi në pikën I, këmbimi në fjalë nënkupton:

1.Prona e paluajtshme në pronësi të komunës së Kaçanikut, pjesa e parcelës kadastrale nr 00587-0 me kulturë oborr dhe shtëpi ndërtesë me sipërfaqe 120 m², zona kadastrale Ivajë dhe,

2.Prona e paluajtshme në pronësi private, parcela me nr 00585-2, me kulturë arë e klasës së 6, me sipërfaqe të përgjithshme 122 m², në zonën kadastrale Ivajë, e evidentuar në emër të Ilmi (Nuhi) Rexha.

III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës:

- Kërkesa e ushtruar nga Ilmi Rexha

- Certifikatat e pronësisë
- Manuali i studiuar nga gjeodeti i licensuar

IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

V. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.



Arsyetim

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit duke shqyrtuar kërkesen Nr06-941/01-4538/22 të parashtruar nga z. Ilmi Rexha që të bëhet këmbimi i pronës komunale me ate private, ku ka konstatuar që ky këmbim është me interes të përgjithëshem publik, për arsye se rruga kryesore "Brigada 162 Agim Bajrami" që është ndërtuar para shumë vitesh lidhë fshatrat: Gajre, Ivajë dhe Strazhë, e cila është e domosdoshme për qarkullim dhe kalon nëpër parcelen e 00582-2 Zona Kadastrale Ivajë dhe siperfaqet e këmbimit janë pothuajse të barabarta. Kjo drejtori duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke pasur parasysh se kjo rrugë e cila ka karakter të interesit të përgjithshëm publik, pas miratimit të këtij Propozim Vendimi nga ana e Kuvendit të Komunës do të filloj me procedurat e këmbimit të pasurisë së paluajtshme të theksuar më lartë.

Drejtori
Qamil Stagova

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Qamil Stagova", is written over a horizontal line.

 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KAÇANIKU
Drejtorati / Njesia Zyra e Kadastër Urbanizëm, Kadastër e Mjedisë		Data 16.02.2022 (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:			Mos shkruani në Pranuar nga: Numri i protokollit: 0634164538 Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri ILMI REXHA	Lloji dhe numri i dokumentit identifikues 1500022902		
Data e lindjes 21.03.1968 (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit fsh. IVAJE - Kaçanik (numri i shtëpisë/banesës, ruga, fshati/qyteti, kodi postar)		
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil 046172329	E-mail adresa	
Mos shkruani në			

2 Selektro llojin:	
Kërkesë ☒	Ankesë ☐

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:
<i>Kërkoj nga titulli i lartëpërmendur</i> <i>- Zyra e Kadastër në Kaçanik që të</i> <i>mi lëshoj informacionet kad.-gjëoshke</i> <i>për parc.nr. 587-0 P.Sh.e Komunës</i> <i>- Gëtitifikatën e pronës</i> <i>- Kopsen e planit dhe</i> <i>- Koordinatat e pikave</i> <i>Aksya:</i> <i>- kërkoj që të bëhet këmbimi-ndërimi</i> <i>i pjesës kad.nr. 587-0 me pjesën e</i> <i>parc.nr. 585-2 (qyteti është rrugë e asfaltuar)</i> <i>e që është pronë e imja.</i> <i>- Mbësë me shpresë se kërkesa i unë</i> <i>dotë miratet parasysh</i> <i>- Ju falënderoj - Respekt!</i>

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi	
Unë Ilmi Rexha (Emri i plotë i aplikuesit)	vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. Rexha (Nënshkrimi)

*** Ju lutemi të kërkontë nga zyrtarja hetëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***

582-0

584-0

1062-0

585-1

583-0

734-0

586-0

120 m²

587-0


1400

590-0

588-0

585-2

122 m²







Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës- Vlada Kosova- Government of Kosovo
Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of
Infrastructure and Environment

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY

PROCESVERBALI NGA TERRENI

Gjeodeti / Kompania gjeodete e licencuar: Geoproject	Numri i licencës: 7
Komuna: Kaçanik	Zona Kadastrale: Ivajë
Numri i njësisë kadastrale: 585-2 dhe 587-0	

Matja/piketimi është realizuar me:	
GPS/GNSS	☒
Stacion Total	☐

1. Përshkrimi i procesit:

Bazuar ne kerkesen e palës ne teren kemi piketuar parcelen 585-2 dhe parcelen 587-0 .

- *Parcela nr 585-2 me siperfaqe prej 122 m² që ne gjendjen faktike eshte rruge e asfaltuar ,pronë e Ilmi Rexha*
- *Pjesa e parceles nr .587-0 me siperfaqe 120 m² pronë e Kuvendit Komunes Kaçanik*

Pala Ilmi Rexha kerkon Kuvendit Komunes Kaçanik bazuar ne gjendjen faktike ne teren te beje kembimin e parceles 585-2 me siperfaqe 122 m² me pjesen e parceles 587-0 qe ka siperfaqe 120 m² e cila eshte paraqitur ne skicen e bashkangjitur kerkeses

Emri (emri i prindit) mbiemri	Numri personal	Numri i njësisë kadastrale	Nënshkrimi
Ilmi (Nuhi) Rexha	1500022902	585-2 dhe 587-0	<i>Rexha</i>

Nënshkrimi dhe vula e gjeodetit:



Data: 21.03.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

LETERNJOFTIM ЛИТНА КАРТА IDENTITY CARD

Mbiemri/Prenjmeri/Name

REXHA

Emri/Imer/First name

ILMI

Gjenera/You/Sex

M

Data e lindjes/Datum poljasa/Date of birth


21.03.1966

Vendi i lindjes/Metro poljasa/Place of birth

IVAJË

Data e skadimit/Datum skadencs/Date of expiry

14.07.2019



Data e lëshimit/Datum izdavanja/Date of issue

14.07.2009

Lëshuar nga/Snyzha koja izdaje/Issuing authority

MPB / MUP / MIA

Numri personal/Licentni broj/Personal number

1500022002

QKRC/OLBP/MCRC

0701S

Nr kq.b.p sk.lid.no

ID02791152





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917041-00587-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

Certificate draft

19.03.2022 - 12:06

KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

Ivajë / Ivaja / Ivajë

KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917041-00587-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	1534			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZYRA E VENDIT				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area	Sipërfaqja Površina (m²) (m²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoriste/Back Yard		1434	
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shëpiti-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		100	

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postat Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Kaçanikut	600246913	/ / /		QAMIL ILAZI	1/1		



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917041-00585-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

207-2022

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

19.03.2022 - 11:55

Komuna / Opština / Municipality:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Ivajë / Ivaja / Ivajë

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917041-00585-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina Privately owned Land	Rural	122		02.03.2022	02.03.2022

A.I ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ARA XHAMILJES			02.03.2022	02.03.2022

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 6/Njiva 6 Klasse/6th Class Arable Land	122

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postat Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	REXHA ILMI (NUHI)	KCID0901086	IVAJË / IVAJA / IVAJË /		20	1/1		18.03.2022



18.03.2022

06-941/01-8081/2022

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092, për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme dhe nenit 6 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit bënë këtë:

PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2022, të merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK, PËR KËMBIMIN E PRONËS KOMUNALE ME ATË PRIVATE

I. VËRTETOHET se pjesa e parcelës me nr: 00174-0- në zonën kadastrale Kovaçec, me sipërfaqe të përgjithshme 273 m², është me interes të përgjithshëm publik dhe mund të fillojnë me procedurat e këmbimit të pronës komunale me pronën e paluajtshme private.

II. Sipas këtij propozimi në pikën I, këmbimi në fjalë nënkupton:

1.Prona e paluajtshme në pronësi të komunës së Kaçanikut, pjesa e parcelës kadastrale nr 00170-0 me sipërfaqe 314 m², zona kadastrale Kovaçec dhe,

